

Statistikat e transportit

Maj, 2018

Tiranë, më 27 Qershor 2018: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Maj 2018 është 365 mijë ton, duke u ulur 6,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në pesëmujorin e parë 2018, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.663 mijë ton, duke u rritur me 2,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 2.316 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 27,6 % krahasuar me Maj 2017.

Për pesëmujorin e parë 2018, ky volum është 6.716 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 33,1 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Maj - 2017	390.080	3.200	218
Maj - 2018	365.435	2.316	183
Ndryshimi vjetor (%)	-6,3	-27,6	-16,1
Janar - Maj 2017	1.621.851	10.032	907
Janar - Maj 2018	1.663.263	6.716	900
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	2,6	-33,1	-0,8

* Përfshin mallrat dhe postën

Në muajin Maj 2018, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 183 ton.

Në pesëmujorin e parë 2018, me ajër janë transportuar 900 ton mallra, duke u ulur 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2017.

Numri i fluturimeve të kryera, në Maj 2018, është 2.044 duke shënuar një rritje me 12,2 %, ndaj Maj 2017.

Për publikim 27/06/2017

Në pesëmujorin e parë 2018, janë kryer 9.460 fluturime, duke u rritur me 8,8 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Maj - 2017	15	1.822	15.009
Maj - 2018	19	2.044	16.428
Ndryshimi vjetor (%)	26,7	12,2	9,5
Janar - Maj 2017	15	8.696	51.216
Janar - Maj 2018	19	9.460	55.294
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	26,7	8,8	8,0

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Maj 2018 është 105.210 pasagjerë, krahasuar me Maj 2017, ky tregues është rritur 10,4 %.

Në pesëmujorin e parë 2018, kanë udhëtuar me linjë detare 312.551 pasagjerë, duke u ulur me 9,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në pesëmujorin e parë 2018, transporti ajror i pasagjerëve zë 74,7 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në pesëmujorin e parë 2018 është 992.636 duke u rritur me 11,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Maj - 2017	7.539	95.312	192.938
Maj - 2018	8.094	105.210	220.117
Ndryshimi vjetor (%)	7,4	10,4	14,1
Janar - Maj 2017	15.457	345.550	890.742
Janar - Maj 2018	23.546	312.551	992.636
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	52,3	-9,5	11,4

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Maj 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 87 mld lekë dhe 53,0 % e tyre u transportua me det.

Në pesëmujorin e parë 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 387 mld lekë dhe 54,6 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave


Në Maj 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 53,8 %, me rrugë 38,5 % dhe me ajër 0,2 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në Maj 2018, janë rritur me 22,2 % dhe me hekurudhë janë ulur me 80,7 %, krahasuar me Maj 2017.

Në pesëmujorin e parë 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 59,1 %, me rrugë 33,8 % dhe me ajër 0,4 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në pesëmujorin e parë 2018, janë rritur me 16,5 % dhe me det janë rritur me 9,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Maj 2018



Importet e mallrave


Në Maj 2018, mallrat e importuara me det zënë 52,6 %, me rrugë 43,4 % dhe me ajër 3,0 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në Maj 2018, janë ulur me 22,1 % dhe me rrugë janë rritur me 1,3 %, krahasuar me Maj 2017.

Në pesëmujorin e parë 2018, mallrat e importuara me det zënë 52,3 %, me rrugë 42,5 % dhe me ajër 2,9 %.

Mallrat e importuara me det, në pesëmujorin e parë 2018, janë rritur me 11,0 % dhe me hekurudhë janë ulur me 16,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Maj 2018



Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë